

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SHA



KATALOG

“BLERJE ORENDISH DHE PAJISJESH PËR MOBILIM”



2024

PËRMBAJTJA

1. Fjalor i termave	Faqe 3
2. Hyrje	Faqe 4
3. Objekti	Faqe 5
4. Artikujt dhe specifikimet teknike	Faqe 6-65
5. Testim Tregu	Faqe 66
5.1 Tabela me çmimet për çdo artikull	Faqe 67-78

1. FJALORI I TERMAVE

OBP → Operatori i Blerjeve të Përqendruara

AK → Autoriteti Kontraktor

Mallra → Prodhime që shiten për të plotësuar një nevojë

BLERJE ORENDISH DHE PAJISJESH PËR MOBILIM → Në këtë kategori përfshihen: tavolina, karrige, skrivani, poltrona, etazherë (rafte), kasaforta, dollape, komodina si dhe materiale të tjera që janë në funksion të mobilimit të zyrave dhe institucioneve arsimore.

2. HYRJE

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sha, në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në zbatim të nenit 13 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe VKM-së nr. 531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë”, e cila, funksionon si Organ Qendror Blerës, misioni i të cilit konsiston në kryerjen e procedurave të përqendruara të prokurimit për mallra, punë, shërbime, të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës ka hartuar katalogun e standardeve për objektin e prokurimit **“Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim”**.

Në gërmën “ç”, të pikës 11, të VKM-së nr 531 datë 7.9.2023 është përcaktuar: “Operatori i Blerjeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve, si: ... ç) “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim”.

3. OBJEKTI

Objekt i këtij katalogu është përcaktimi i specifikimeve teknike për çdo artikull në funksion të përzgjedhjes nga ana e autoriteteve kontraktore, sipas nevojave të tyre.

Specifikimet teknike të përgjithshme të produkteve, kanë të përcaktuara karakteristikat e produktit, përshkrimin e produktit, kërkesat cilësore, sasiore, ambalazhimin, etiketimin.

Specifikimet teknike përshkruajnë saktë dhe në mënyrë të plotë, duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoriteteve Kontraktore dhe duke ju referuar gjendjes së tregut për secilat nga këto kërkesa, Specifikimet teknike janë hartuar me qëllim që të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë palët e interesuara.

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ose ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

4. ARTIKUJT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Tabela e Specifikimeve Teknike për objektin e prokurimit: "Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim"


Nr.	Emërtimi i artikujve	Përshkrimi i artikujve	Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi)	Njësia matëse
1	Banak për reception	<p>Banaku përbëhet nga suprina e madhe 250 x 70 cm mbi të cilën qëndron suprina e vogël në lartësinë 38 cm me dimensione 250 x 30 cm. E gjithë mobilja do të ndërtohet me material pllake zdrukthi të melaminuar 25 mm. Ato kanë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Anësorja dhe ballorja e banakut do të ndërtohet po me të njëjtin material. Në të njëjtin plan, në lartësinë 38 cm nga suprina e madhe vendoset suprina e vogël me dimensione 30 x 250 cm, e cila është pjesë e mbështetjes së klientit. Të gjithë elementët e banakut të receptionit të jenë të borduara me material plastik PVC me trashësi 1mm. Pjesë e receptionit është dhe një sirtarierë e lëvizshme, specifikimet teknike të së cilës i kemi dhënë më vete.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN,e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004</p>	250 x 70 x 110 cm	Copë
2	Reception ne formë U-je	<p>Ky reception modern përmban sipërfaqe të melaminuar që i rezistojnë gërvishtjeve dhe njollave nga lëndët e lëngshme. Trashësia e pllakës së përdorur 18 mm. Suprina është me panele laminati ngjyrë argjendi që përputhet me xokolen e përparme të mobiljes duke theksuar rifiniturën. Katër unaza metalike gjenden në sipërfaqe për të mbajtur telat/kabllo të fshehura dhe të organizuara. Karakteristika unike e kësaj tryeze është suprina e qelqit të temperuar që duket se noton mbi sipërfaqe dhe mbështetet nga këmbëza prej metali ngjyrë argjendi. Kjo tryezë përbëhet nga dy tavolina të drejta 120cm, dy tavolina të harkuara dhe një kthim tavolinë kthimi që mund të vendosen në të dy anët. Mobilja e receptionit të jetë e paisur me sirtare.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN,e njëvlefshme ose e përditësuar),SSH EN 13721:2004</p>	<i>Tavolinat e drejta:</i> Min 120x80x105cm <i>Tavolina me hark:</i> Min 80x80x105cm <i>Tavolina e kthimit</i> Min 80x80x75 cm, Dimensione: Min 280x200x105 cm Max 300x220x120 cm	Copë

3	Dollap metalik (mbajtëse dizenjosh horizontal)	<p>Dollapi metalik për mbajtje dizenjosh me sirtarë, është i përbërë, prej dy pjesëve me struktura të veçanta metalike që vendosen mbi njëra tjetrën dhe kanë nga pesë sirtarë secila. Sirtarët duhet të jenë me çelës qendror, ku çdo pesë sirtarë të secilës strukture të dollapit të mbylljen e të hapen njëkohësisht. Sirtarët duhet të kenë doreza plastike, në mënyrë që të mos dëmtohen gjatë hapjes dhe mbylljes. Lyerja duhet të jetë e realizuar me bojë të pjekur në furrë me temperaturë 180°C.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	125 x 87 x 10 cm	Copë
4	Dollap metalik me dyer	<p>Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	92 x 40 x 195 cm	Copë
5	Dollap metalik me dyer (hapje formë flamuri)	<p>Dollap metalik duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Dyert janë me hapje në formë flamuri. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	92 x 40 x 195 cm	Copë
6	Dollap metalik me kanata rrëshqitëse	<p>Dollap metalik me kanata rrëshqitëse duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Dollapi është me kanata rrëshqitëse. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	120 x 45 x 200 cm	Copë

7	Dollap metalik me sirtar	<p>Dollap metalik me sirtar duhet te ketë strukture prej çeliku te lyer qe ti rezistojë korrozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të ketë 3 sirtarë që hapen plotësisht dhe lehtësisht. Pjesa e brendshme të jete e konstruktuar qe të mbajë minimumi 50 dosje me fletë A4 në çdo sirtarë dhe te ketë një mekanizëm qe shmang përmbysjen e sirtarit ne momentin e hapjes maksimale. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi. Sirtarët duhet të kenë sistem qendror mbyllje me çelës dhe te shoqërohet me dy çelësa rezervë.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	46 x 62 x 133 cm	Copë
8	Dollap për dosje dy kanatesh	<p>Skeleti dhe kanatet duhet te jenë prej materiali melaminë me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Sergjenet do jenë prej materiali pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Materiali të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve të jenë të veshura (borduar) me material plastik PVC me trashesi 1mm. Kanatet të mbyllen me çelës. Pjesa e brendshme të ndahet në 5 (pesë) hapësira me sergjenë me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Shpina e mobiljes të jetë fibër 4mm trashësi.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	80 x 45 x 180 cm	Copë
9	Dollap për regjistra	<p>Materiali i korpusit dhe i nëndarjeve prej melamine 1.8 cm me bordin PVC 0.8 mm. Rafti përbëhet nga dy kapakë që mbyllen me çelës. Rafti ka minimum 6 ndarje horizontale dhe mbështetet mbi këmbë 6 cm me mekanizëm nivelues.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	90 x 45 x 185 cm	Copë


10	Dollap për dosje një kanatesh	<p>Skeleti dhe kanati do jetë prej materiali melaminë me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Sergjenet do jenë prej materiali melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Materiali drusor të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve të jenë të veshura (borduara) me material plastik PVC. Kanati të mbyllen me çelës. Pjesa e brendshme të ndahet në pesë hapësira me sergjenë me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dollapi te jetë i pajisur me tapa plastike kundër gërvishtjes. Dorezat e kanatit dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	45 x 45 x 180 cm	Copë
11	Dollap për veshje/zhveshje (garderobë)	<p>Dollapi është me dy kanata të mbyllur. Organizimi i brendshëm i dollapit është me raft ndarës në pjesën e sipërme, varëse rrobash tub dhe dy sirtarë në pjesën e poshtme. Materiali është Mdf të melaminuar dhe të borduar me PVC me trashësi 1 mm. Mbyllja me çelës. Aksesorët metalik të jenë cilësorë. Element plastik kundër - gërvishtje për mbështetjen në tokë. Shpina e mobiljes të jetë fibër 4mm trashësi.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	Min 90x45x190 cm Max 100x50x200 cm	Copë
12	Garderobë 3 kanata	<p>Materiali i skeletit dhe kanatet do të jetë prej melaminë, me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve do të jenë të veshura me PVC me trashësi jo me te vogël se 1 mm, e ngjashme me ngjyrën e melaminës. Kanatet do të montohen me mentesha metalike që lejojnë hapjen e lirë të kanateve. Sergjenet do jenë prej materiali melaminë me trashësi 2.5 cm. Materiali të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. të jenë të veshura (borduara) me material plastik PVC Kanatet të mbyllen me çelës. Pjesa e brendshme të ndahet në minimum 5 (pesë) hapësira me sergjene me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	120 x 55 x 200	Copë


13	Dollap rrobash për zyra (një kanat)	Skeleti dhe kanati duhet të jenë prej materiali melaminë me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Materiali të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të dukshme të skeletit dhe kanatit të jenë borduara me material plastik PVC. Kanati të ketë mbyllje me çelës. Në pjesën e brendshme të ketë tub për varjen e rrobave dhe ndarje që formojnë dy hapësira në pjesën e poshtme. Të jetë i pajisur me tapa plastike kundër gërvishtjes. Dorezat e kanatit dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004	45 x 55 x 200 cm	Copë
14	Dollap garderojë për fëmijë	Dollapi do të përbëhet nga dy fjango anësore njëtrupëshe ku montohen dhe mbështeten dy kanata me lartësinë 160 cm. Pjesa lart e dollapit është e hapur për vendosjen e çantave dhe objekteve të ndryshme. Në pjesën e brendshme ai është i ndarë në 4 hapësira nëpërmjet 3 sergjeneve. Pjesa e pasme është fibër me spesor 3 mm e montuar në të gjithë perimetrin e saj. Për çdo pjesë të ketë dy kanata me hapje 90 gradë, me ristelë mbrojtëse në mbyllje, doreza e brava me çelës. I gjithë dollapi mbështetet mbi këmbëza plastike me lartësi 6 cm. Lart dhe poshtë do të ketë shula për fiksimin e kanateve. Materiali i gjithë dollapit do të jetë melaminë me trashësi 16 mm. Trupi, ndarëset për të gjitha pjesët e dukshme vishen me PVC 0.8 mm.	90 x 45 x 185 cm	Copë
15	Dollap me dy kanata	Materiali i skeletit dhe kanatet do të jetë prej melaminë, me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve do të jenë të veshura me PVC me trashësi jo më të vogël se 1 mm, e ngjashme me ngjyrën e melaminës. Kanatet do të montohen me mentesha metalike që lejojnë hapjen e lirë të kanateve. Sergjenet do të jenë prej materiali melaminë me trashësi 2.5 cm. Materiali të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. të jenë të veshura (borduara) me material plastik PVC. Kanatet të mbyllën me çelës. Pjesa e brendshme të ndahet në minimum 5 (pesë) hapësira me sergjene me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004	90 x 45 x 210 cm	Copë



16	Dollap me katër kanata	<p>Materiali do të jetë prej melamine, me trashësi 1.6 deri 1.8 cm dhe anësoret do të jenë të veshura me PVC me trashësi jo më të vogël se 1 mm, e ngjashme me ngjyrën e melamines. Kanatet do të montohen me mentesha metalike që lejojnë hapjen e lirë të kanateve. Hapësirat e brendshme do të jenë të përshtatshme për vendosjen e rrobave. Në të dy anët rafti do të jetë i pajisur me tub metalik për varjen e rrobave, në pjesën e poshtme në lartësinë 30 cm pa lartësinë e këmbëve do të vendoset një sergjen. Rafti do të ndahet në dy pjese me përmasa 90 x 60 x 210 cm për mundësi transporti. Në pjesën fundore do të jetë i pajisur me këmbë metalike 5 cm me mundësi regjistrimi.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	180 x 60 x 210	Copë
17	Dollap	<p>Me bango (imitim mermeri të bardhë) 4 cm, materiali MDF me lyerje 1.8-2 cm, me tre ndarje ku dy janë me kanata dhe një e hapur me ndarje në mes. Struktura e brendshme pllake zdrukthi e melaminuar 1.8cm. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Shpina e mobiljes te jete fiber 4mm trashesi.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p> 	120 x 50 x 85 cm	Copë
18	Etazhier (Raft) për zyrë	<p>Syprina material MDF i lyer 2.5 cm, pa kapakë, panelet ndarëse duhet të jenë me spesor 2.5cm me material MDF. Do të jetë i ndarë me sergjenë. Skeleti dhe sergjenët do jenë prej material MDF me lyerje dhe me trashësi 2.5 cm. Materiali MDF duhet të jetë me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paketohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyra e bardhë. Shpina e mobiljes të jetë fibër 4mm trashësi.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	150 x 40 x 130 cm	Copë

19	Etazhier për zyrë e veçantë	<p>Syprina e etazhierit të jetë prej material melamine me spesor 18-25 mm. Kapakët duhet të jenë xhami të temperuar me telajo (kornize) melamine. Etazhieri ndahet në dy hapësira nëpërmjet sergjenit i cili ka spesor 25 mm. Faqet (bordet) anësore të materialit të jenë të borduara me material plastik PVC. Shpina e mobiljes te jete fiber 4mm trashesi.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	530 x 35 x 125 cm	Copë
20	Portmonto	<p>Materiali i përdorur do jetë melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Të qëndrojnë mbi 4 këmbë metalike të kromuara me mundësi nivelimi. Në pjesën e poshtme të ketë një dollap me dy kanata deri në lartësinë 60 cm pa lartësinë e këmbëve me thellësi 40 cm dhe me dy ndarje. Në pjesën e sipërme të ketë një strehë në formë kornize me përmasa 10 cm. Poshtë strehës në një rën nga gjysmat e ndara vertikalisht do jenë të vendosura 5-8, varëse portmontoje në formë zig-zag, kurse në gjysmën tjetër do ketë pasqyrë. Dorezat e kanateve dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011 ose ekuivalenti i tij; SSH EN 527-2:2016 ose ekuivalenti i tij;</p>	80 x 40 x 180 cm	Copë
21	Raft metalik për arkivë	<p>Materiali i përdorur për këmbët do të jetë profil katror 30 x 30 x me spesor 1.6 deri 1.8 mm. Materiali i përdorur për vendosjen (sergjenat) e dosjeve do të jetë lllamarinë e zezë me spesor 1.2 mm. Rafti do të ketë dhe një platformë melamine me shinë që do të shërbejë për një shikim të shpejtë të dosjes ne vend.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	100 x 42 x 250 cm	Copë
22	Raft metalik për dosje (arshivë)	<p>Raftet kërkohen të jenë prej materiali metalik, me strukturë të qëndrueshme për mbajtje sasiore dokumentesh. Të jetë i ndarë me 4 sergjenë. Krahët mbajtës të jenë me vrima për vendosje raftesh horizontale në nivele të ndryshme dhe me mbështetëse gome në pjesën fundore.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	90 x 40 x 200 cm	Copë

23	Rafte metalike	<p>Skeleritë metalike të jenë prodhime cilësore dhe solide me material hekur “L”. Materiali “L”, të jenë prej hekuri cilësi e parë, me spesor jo më të vogël se 4 mm dhe gjerësi 40 mm. Këmbët të jenë të jenë 12 cm nga toka, ndarëset (sergjenet) të jene çdo 50 cm të salduara në mënyrë që të mbajnë pesha të mëdha. Shtresat e sergjenet të jenë prej llamarine me trashësi jo më pak se 1.2 mm e cilësi e parë, e punuar me forma që të mbajë peshën e shpërndarë në mënyrë uniforme në të gjithë sergjenin, jo më pak se 120 kg. Sergjenet të jenë me përmasa 100 x 50 cm x 60 cm thellësi. Raftet të realizohen sipas përmasave të kërkuara, dhe te kenë vrima të hapura ne gjithë lartësinë e trupit të këmbëve për te krijuar mundësitë që te lidhen me njëri – tjetrin me vida dhe bulona.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	100 x 60 x 250 cm	Copë
24	Raft për dosje (etazher)	<p>Skeleti dhe Sergjenet do jenë prej materiali melamine me trashësi 16 deri 18 mm. Kapakët janë me material MDF të plastifikuar me PVC me spesor jo më pak se 16 deri 18 mm. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njejtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë tapa fundore kundër gërvishtjes. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali melaminë, me trashësi jo më të vogël se 18 mm që mbyllen me çelës. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjene me lartësi të regjistrueshme. Pjesa e sipërme është e mbyllur me kapakë xhami (që mund të jenë me ose pa kornizë druri ose metali). Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të sergjeneve që janë të regjistrueshëm sipas nevojës. Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali te kromuar.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	90 x 45 x 190 cm	Copë

25	Raft për dosje, material MDF	<p>Raftet do të realizohen me MDF, ku në pjesën e jashtme ajo do të jetë të veshur me rimeso anigre si tavolinat e zyrës përkatëse dhe do të jenë të lyera me ngjyrë natyrale. MDF që do të përdoret do të ketë spesor 18 mm, me rimeso anigre dhe kjo do të jetë e lyer ngjyrë natyrale. Duhet të kihet kujdes në montimin e pjesëve përbërëse, pasi nuk duhet të jenë në dukje vidat e bashkimit. Në pjesën e poshtme do të vendosen tapa fundore në mënyrë që të ketë një distancë të vogël nga dollapi me dyshtim. Pjesa e mbrapme e dollapit do të jetë me fibër 4 mm. Kanatat prej xhami me korniza inoksi 20 x 20 mm. Xhami do jetë transparent me trashësi 4 mm.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p> 	90 x 45 x 200 cm	Copë
26	Raft për dosje (etazher)	<p>Skeleti dhe Sergjenet do jenë prej materiali Melaminë me trashësi 2.5 cm. Xokola do jetë 11 cm e lartë, e mbuluar dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë këmbëza me mekanizëm nivelues, do të ketë dy kapakë prej materiali pllake zdrukthi e melaminuar, me trashësi jo më të vogël se 1.8 cm që mbyllen me çelës. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjene me lartësi të regjistrueshme. Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali të kromuar.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	128 x 48 x 92 cm	Copë

27	Raft për dosje (etazher)	<p>Skeleti dhe Sergjenet do jenë prej materiali Melaminë me trashësi 2.5 cm. Xokula do jetë 11 cm e lartë, e mbuluar dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë këmbëza me mekanizëm nivelues, do të ketë dy kapakë prej materiali Melaminë, me trashësi jo më të vogël se 1.8 cm që mbyllen me çelës. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjieni me lartësi të regjistrueshme. Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali te kromuar.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p> 	126 x 47 x 80 cm	Copë
28	Raft për dosje (etazher)	<p>Skeleti dhe Sergjenet do jenë prej materiali Melaminë me trashësi 2.5 cm. Xokula do jetë 11 cm e lartë, e mbuluar dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë këmbëza me mekanizëm nivelues, do të ketë dy kapakë prej materiali Melaminë, me trashësi jo më të vogël se 1.8 cm që mbyllen me çelës. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjieni me lartësi të regjistrueshme. Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali te kromuar. Pjesa e mbrapme e dollapit do të jetë me fiber 4 mm.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	129 x 46 x 99 cm	Copë


				
29	Raft për dosje (etazher)	<p>Skeleti dhe Sergjenet do jenë prej materiali Melaminë me trashësi 2.5 cm. Xokula do jetë 8 cm e lartë, e mbuluar dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë këmbëza me mekanizëm nivelues. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 84 cm, pa lartësinë e xokulës, do të ketë dy kapakë prej materiali Melaminë, me trashësi jo më të vogël se 1.8 cm që mbyllen me çelës. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjieni me lartësi të regjistrueshme. Pjesa e sipërme është e mbyllur me kapakë xhami (që mund të jenë me kornizë druri ose metali) dhe që mbyllen me çelës. Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të sergjeneve që janë të regjistrueshëm sipas nevojës. Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali te kromuar. Pjesa e mbrapme e dollapit do të jetë me fiber 4 mm.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	110 x 50 x 228 cm	Copë
				

30	Raft me çelësa	<p>Rafti do të realizohet me MDF, ku në pjesën e jashtme ajo do të jetë të veshur me rimeso anigre si tavolinat e zyrës përkatëse dhe do të jenë të lyera me ngjyrë natyrale. MDF që do të përdoret do të ketë spesor 16 deri 18 mm, me rimeso anigre dhe kjo do të jetë e lyer ngjyrë natyrale. Duhet te kihet kujdes ne montimin e pjesëve përbërëse, pasi nuk duhet të jenë në dukje vidat e bashkimit. Pjesa e shpinës së dollapit do të jetë me MDF 16 deri 18 mm (për arsye të vendosjes së grepave). Duhet të jetë i ndarë në katër pjesë të barabarta, i pajisur me etiketa dhe grepa për vendosjen e çelësave, të mbyllet me çelës si dhe të ketë kapëse për tu varur në mur. Kanatat prej xhami Pajisjet e raftit janë të pajisura me dyer xhami me korniza inoksi 20 x 20 mm. Xhami do jetë transparent, i temperuar me trashësi 4 mm.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	100 x 23 x 140 cm	Copë

31	Raft për çdo mësues në sallën e mësuesve	<p>Raftet do të realizohen me 15 hapësira që qendrojnë mbi njëra tjetrën me lartësi të njëjtë. Hapësirat shërbejnë si sipërfaqe mbajtëse të pajisjeve të klasës. Pjesa e pasme e dollapit është e përbërë me fibër, në faqen e dukshme me të njëjtën ngjyrë dhe dizenjo me pjesën tjetër të dollapit. Për çdo hapësirë të ketë kanata me hapje 90 gradë, dorez e brava me çelës. I gjithë rafti mbështetet mbi këmbëza plastike 6 cm. Materiali i gjithë dollapit do jetë melaminë me trashësi 1.8 cm. Trupi, ndarëset për të gjitha pjesët e dukshme vishen me material plastik PVC (në pjesët anësore). Ndarjet horizontale të raftit prej pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 1.8 cm. Lidhja do të realizohet me aksesore të fshehur. Pjesa e mbrapme e dollapit do të jetë me fiber 4 mm.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	90 x 45 x 185 cm	Copë
32	Raft për bibliotekën	<p>Faqet vertikale janë me melaminë me trashësi 1.8 cm me veshje perimetrale të plastifikuar me PVC 0.8 mm. Rafti ka gjithësej katër ndarje horizontale të brendshme. Ndarëset horizontale të raftit janë melaminë 25 mm me veshje perimetrale të plastifikuar me PVC 0.8 mm. trashësia prej 2.5 cm dhe gjatësia e lirë prej 90 cm është një gjatësi optimale e cila siguron hapësirë të mjaftueshme gjithashtu ruan qëndrueshmërinë dhe nuk deformohet nën veprimin e ngarkesës së librave me kalimin e kohës. Faqja e mbrapme e raftit është me përbërje fibër me trashësi 3 mm. Montimi do të realizohet me aksesore të fshehur.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	90 x 40 x 185 cm	Copë


33	Raft për bibliotekën	<p>Material druri multistrat anigre. Librari e lartë, realizuar me 2 thellësi. Pjesa e poshtme, do të ketë strukturë anësore me trashësi 16-18 mm, me përmasa lartësi 1065 mm, gjatësi 810 mm dhe gjerësi të 610 mm. Ky modul në pjesën e poshtme të lidhet me krahun përballë me një ndarje horizontale me trashësi 70 mm, gjatësi 774 mm, gjerësi 610 mm. Në pjesën e sipërme moduli të mbyllet po me një raft ndarës por me trashësi. 40 mm, gjatësi 774 mm dhe gjerësi 610 mm. Shpinorja të jetë e dukshme me spesore 6-8 mm. Në mes të strukturës, për të lejuar sistemimin e librave, duhet të jetë e pajisur me një raft ndarës me përmasa gjatësi 774mm, gjerësi 610, trashësi 20mm. Pjesa e sipërme, duhet të jetë e ndërtuar nga 2 anësore me dimensione: gjatësi 1540 mm gjerësia 505 mm, trashësia 16-18 mm. Në pjesën e sipërme moduli të mbyllet po me një raft ndarës por me trashësi 40 mm gjatësi 774mm dhe gjerësi 505 mm. Shpinorja e dukshme të ketë trashësi 6-8 mm. Në pjesën qendrore të strukturës, për të lejuar sistemimin e librave, duhet të jetë e pajisur me tre raftet ndarës me dimensione gjatësi 774mm, gjerësi 497 mm, trashësi 20 mm. Materiali i librarisë duhet të jetë në dru apo kompensate trajtuar kundër lagështirës dhe reflektimit të dritës. Raftet e brendshme janë të pajisur me element mbajtës të padukshme, të cilët ndihmojnë në qëndrimin e strukturës anësore, duke balancuar peshën në momentin e mbushjes me libra apo materiale të tjera zyre.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	L 81 H 260 P 50.5/61 cm	Copë
----	-----------------------------	--	-------------------------	------





34	Raft librash i hapur	<p>Raft librash me minimum 4 hapësira dhe një dollap i poshtëm me dy kanata. Struktura dhe ndarjet e brendshme janë të përbërë nga panele mdf me trashësi 18 mm të veshura me melamine ngjyre e bardhë dhe bordet e tyre janë të veshura me material PVC me trashësi 0.4mm me ngjyre të bardhë. Kanatat kapen me mentesha metalike me hapje deri 110°. Shpina e mobiljes me fibër 4 mm trashësi ngjyrë e bardhë.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	Min 90 x 45 x 200 cm Max 100 x 55 x 210 cm	Copë
----	-----------------------------	---	--	------

35	Raft i pjerrët librash	<p>Dy ndarje për vendosjen e librave me pjerrësi 45 gradë dhe me mbrojtëse që të mos rrëshqasin librat. Rafti përbëhet nga dy anësoret me diferencë në gjerësi nga dy ekstremet 40 mm, fundi dhe syprina e cila është 40 mm me gjerësi më të vogël dhe dy ndarëset. Rafti i pjerrët ndërtohet me melaminë cilësore me trashësi 18 mm. Bashkimi i elementëve bëhet me aksesore të padukshëm. Rafti mbështetet mbi këmbë plastike me lartësi 50 mm, të cilët e mbrojnë nga lagështira dhe dëmtime të ndryshme gjatë lëvizjes. Pjesa e mbrapme e dollapit do të jetë me fiber 4 mm.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	900 x 400 x 760 mm	Copë
36	Raft i ulët që paloset me rrota (raft dysh i lëvizshëm)	<p>Mbështetur mbi xokolaturë dërrase dhe mbi rrota plastike të vogla të vendosura në 4 cepat e raftit poshtë. Lidhja dhe montimi të jenë me bulona të fshehur. Prodhimi me material melaminë me trashësi 18 mm. Sergjeni horizontal do të realizohet me pllakë melaminë të veshur me shirita plastike. Bashkimi i rafteve me mentesha shirit për të krijuar mundësinë e palosjes.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 1729-2:2012+A1:2015</p>	Lartësia 71cm; Gjerësia 2 x 120cm; Thellësia 28 cm	Copë
37	Raft lodrash/mjet esh	<p>Struktura melaminë 18 mm me veshje perimetrare PVC 0.8 mm. Brenda saj janë të ndara me rafte për vendosjen e lodrave të fëmijëve. Është funksionale dhe në to mund të vendosen kasone të ndryshëm plastik të mbushura me lodra fëmijësh. Bordurimet anësore janë të veshura me PVC me spesor 0.8 mm. Rafti mbështetet mbi këmbë me lartësi 6 cm.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-2:2012 +A1:2015</p>	120 x 140 x 60 cm	Copë
38	Librari për dosje gjysmë e mbyllur, rang drejtuesi tip B	<p>Skeleti dhe kanatet do jenë prej materiali dru-mdf- melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Sergjenet do jenë prej materiali dru-mdf-melamine me trashësi 2.5 cm. Veshje MDF me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Xokula do jetë 2 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve të jenë të harkuara. Kanatet të jenë pa doreza në ballore, me dorezë të fshehur. Pjesa e brendshme të ndahet në hapësira sipas skicës dhe pjesët e hapura të mos kenë pjesë mbyllëse të prapme. Njëra prej kanatave, sipas skicës të jetë e pajisur me çelës Aksesorët e përdorur të jenë cilësorë.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>		Copë

				
39	Komodina dyshe (ushtari)	<p>Materiali i përdorur do jetë melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të veshur me material plastik PVC. Ato duhet të jenë të pajisura me një sirtar në pjesën e sipërme dhe pjesën mbajtëse të rrobave që mbyllet me dy kapakë. Komodina qëndron mbi 4 këmbë metalike me lartësi 5 cm nga toka dhe të pajisura me mekanizëm regjistruar. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar) , SSH EN 13721:2004</p>	60 x 40 x 80 cm	Copë
40	Komodinë zyre	<p>Materiali i përdorur do jetë melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të veshur me material plastik PVC. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004</p>	45 x 60 x 65 cm	Copë

41	Komo me pasqyrë	<p>Materiali do të jetë melaminë me trashësi 1.6 deri 1.8 cm, në të gjitha anët do të jetë e veshur me një shtresë PVC jo me te vogël se 1 mm. Komoja do të ketë 4 sirtarë të cilët mbështeten mbi shina metalike duke bërë të mundur me lehtësi lëvizjen tyre. Pjesa e mbrapme e dollapit do të jetë me fiber 4 mm. Pasqyra do të vendoset në një kornizë melamine në përmasa 90 x 90.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004</p>	90 x 55 x 80 cm	Copë
42	Mobilje për kuzhinë	<p>Mobilje për kuzhinë me të dyja pjesët (lart dhe poshtë) ku përshtatet lavamani i inkastruar, frigoriferi, etj. Në pjesën e poshtme duhet të jetë me kanata të mbyllura dhe sirtare. Mobilja është prej druri të përpunuar të veshur me laminat lehtësisht e pastrueshme. Syprina është e plotë me trashësi 4 cm me një prapavijë të përshtatshme me lartësi 10cm, lavaman inox me një rubinet me levë të vetme, Struktura dhe ndarjet e brendshme dhe kanatat janë të përbërë nga panele mdf me trashësi 18 mm të veshura me melamine ngjyre druri. Kanatat kapen me mentesha metalike. Pjesa e poshtme mbështetet në këmbë plastike 10 cm që mbulohet me xokole me veshje alumini. Në pjesën e sipërme të vendoset një mbajtëse pjatash mbi lavapjatë. Dorezat janë në formë paralepipedi prej materiali polipropileni ngjyre argjendi. Të gjitha kanatat janë të varura në mentesha të cilësore. Pjesa e mbrapme e dollapit do të jetë me fibër 4 mm.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1116 : 2018</p>	Min 400x85x75 cm Max 410x90x80 cm	Copë
43	Lavaman inoksi me 2 gropa	<p>Lavamani me dy gropa dhe 1 ose 2 rubineta. Materiali në inoks. Lavamani furnizohet i plotë me kullues, sifon, lidhje fleksibël me rrjetin e ujit dhe prizat për montim në mur. Celik inoks sipas standartit AISI 304 (trashësi min 1.27mm).</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 13310:2015 +A1:2018</p>	Min 170x60x75cm Max 180x65x80cm	Copë
44	Lavaman të inkastruar brenda mobiljes, mobilja me 2 sirtare	<p>Dollapi me komplet lavamani është bërë prej druri të përpunuar të veshur me laminat lehtësisht e pastrueshme. Dollapi bazë ka një syprinë të plotë të trashë 4 cm me një prapavijë të përshtatshme me lartësi 10 cm, lavaman inox 40 x 40cm me një rubinet me levë të vetme, një sirtar ruajtjeje dhe dy kanata me një raft. Struktura dhe ndarjet e brendshme janë të përbërë nga panele mdf me trashësi 18 mm të veshura me melamine ngjyre druri. Kanatat kapen me mentesha metalike me hapje deri 110°. Dorezat janë në formë paralepipedi prej materiali polipropileni ngjyre argjendi, Të gjitha kanatat janë të varura në mentesha cilësore.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1116 : 2018</p>	Min 90x60x75cm Max 100x70x85cm	Copë

45	Shpërndarës ushqimi me rrota	Me skelet metalik prej tubash çeliku Ø18 mm të harkuar me lyerje elektrostatische. Bazamenti i katit të parë dhe të dytë janë plastik prej polietileni. Montohen në skeleton metalik me vida. Bazamenti i katit të parë është 20 cm nga toka dhe mbështetet mbi 4 rrota me pajisje frenimi. Bazamenti i katit të dytë nga kati i parë 54 cm, 20 cm pjesa bosh mbi katin e dytë.	Dy kate me gjerësi 63 cm, Thellësia e katit të poshtëm 93 cm, dhe e katit të sipërm 50 cm, Lartësia është 94 cm, Pesha mbajtëse 19 kg.	Copë
46	Sirtarierë e lëvizshme me rrota	Struktura e sirtarierës do jetë melaminë me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Syprina dhe kapakët ballore të sirtarëve duhet të jenë prej material melamine me spesor. Bordet anësore, fiankeve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Sirtariera duhet të ketë 4 rrota sferike në fund dhe të mund të lëvizë nën tavolinë. Sirtari i parë nga lart duhet të jetë më i vogël dhe i përshtatur për të mbajtur sende të imëta, pjesa tjetër të ndahet në 3 sirtarë të barabartë. Sirtarët duhet të jenë të pajisur me kyç që të realizojë mbyllje qendrore. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarierës. Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	45 x 53 x 60 cm (lartësi së bashku me rrotat)	Copë
47	Sirtarierë metalike	Dollapët metalike (mbajtëse dizenjosh horizontal), me sirtarë duhet të jenë prodhime cilësore dhe solide. Ato duhet të shërbejnë për mbajtjen e dizenjove rulon ose fletë të formatit AO (1200 x 850 mm). Duhet të jenë të ndërhuara prej një strukture llamarine çeliku e llakuar me spesor 0.8/1 mm, në të cilën vendosen sirtarë. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004	137 x 95 x 122 cm	Copë

48	Skeleri metalike për arkivë	<p>Skeleria (raftet) duhet të jenë prodhime cilësore dhe solide. Skeleria metalike të jenë sisteme modulare të përmasave të ndryshme, çka i bën ato ti përshtatën sa më mirë dhe pa humbje hapësire çdo ambienti e nevojë. Pjesët përbërëse të skelerisë duhet të jenë: Kolonat, Sergjenet, Lidhëset e kolonave, Tapat për kolonat , Aksesorë të ndryshëm fiksues në vartësi të vendit dhe mënyrës së vendosjes. Kolonat të jenë prej metali cilësi e parë, me spesor jo më të vogël se 1.2 mm. Kolonat të jenë me dallgëzime të studiuara, në mënyrë që të mbajnë pesha të rënda dhe me fole në çdo 5 cm, të cilat shërbejnë për futjen e ganxhave mbajtëse të sergjeneve. Sergjenet të jenë prej llamarine me trashësi (spesor) 0.8-1mm. Përmasat e sergjeneve të jenë 100 x 40 cm. Anët e sergjenit të jenë të kthyer të paktën tre herë si edhe të ketë një lartësi prej 3 cm. Peshëmbajtja e një sergjeni të jetë 200 kg (peshë) e shpërndarë. Fiksimi i sergjeneve të bëhet me ganxha. Skeleria metalike të jenë krijuar, në mënyrë që të lidhen linearisht me njëri-tjetrin.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	100 x 40 x 230 cm	Copë
49	Skeleri metalike	<p>Skeleritë metalike të jenë prodhime cilësore dhe solide. Këmbët e skelerive të jenë prej metali cilësi e parë, me spesor jomëtëvogël se 1.2mm. Këmbët të jenë të dallgëzime të studiuara në mënyrë që të mbajnë pesha të mëdha dhe me fole në çdo 50 cm të cilat të shërbejnë për futjen e ganxhave mbajtësetësergjeneve. Montimi i këmbëve me sergjenet të mos bëhen me bulona, por me ganxha mbajtëse të konfiguruar. Seksioni i këmbëve të jetë me përmasa (35 x 500 mm) në ballë dhethellësi. Sergjenet të jenë prej llamarine me trashësi jo më pak se 1.2 mm e cilësi e parë, e punuar me forma që të mbajë peshën e shpërndarë në mënyrë uniforme në të gjithë sergjenin, jo më pak se 120kg. Sergjenet të jenë me përmasa 100 x 40 cm thellësi dhetëmbahen me katër ganxha. Skeleritë të realizohen sipas distancave dhe ndarjeve të kërkuara dhe të kenë mundësitë lidhen me njëri – tjetrin.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004</p>	100 x 40 x 270 cm	Copë

50	Kasaforta sekrete	Kasaforta duhet të ketë strukturë llamarinë me trashësi jo më pak se 1.5 mm. Të ketë dy ndarje horizontale nga brenda, ku të krijohen tre hapësira. Dera të jetë e pajisur me dorezë dhe bravë automatike sekrete. Lyerja me mënyrë elektrostatische. Bazamenti të jetë jo më pak se 10 cm.	50 x 50 x 110 cm	Copë
51	Dërrasë e zezë	Të dhënat teknike të saj janë: Mënyrë tradicionale e paraqitjes, shkruhet me shkumës. Sipërfaqe e lyer me ngjyrë të zezë ose jeshile, e lehtë për t'u fshirë falë strukturës ekstra të imët të sipërfaqes. Sipërfaqe jo gërvishëse dhe rezistente ndaj acideve. Ngjyrë e zezë ose jeshile mat me sipërfaqe jo reflektuese. Dorëzimi të bëhet duke përfshirë mbajtësen e shkumësave dhe kompletin e montimit. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 14434:2010	120 x 180 cm	Copë
52	Karrige kopshti	Materialet skelet me konstrukcion druri, ahu I staxhionuar. Ulësja dhe mbështetësja e karriges e formësuar multistade (kompesatë shumë shtresore), me dekore të ndryshme ose me ngjyra të çelura. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1130:2019/AC:2020	55 x 29 x 32 cm	Copë
53	Karrige nxënësi cikël i ulët	Mbështetëset dhe ulëset të jenë me material frezilit, i derdhur ne te gjithë trupin e ndenjtes dhe te shpines. Materiali i derdhur i frezilitit duhet te jete i qendrueshem kunder lageshtires dhe gervishtjeve. Ndenjtësia dhe shpina të jene te harkuara (me gropa në qendrën e ulëses dhe ne forme anatomike. Skeleti duhet te jete me profil tubolar oval ku ne te dyja anet e tubit te jete i rumbullakosur, qe te japi fortesine dhe imazhin e dukshem te karriges, me seksion jo më të vogël 30 x15mm dhe spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm. I gjithë skeleti të jetë i salduar me saldime të vazhduar me argon dhe i lyer me bojë elektrostatische, në pjesët fundore të ketë tapa plastike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012+A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)	35 x 38 x 37/70 cm	Copë
54	Karrige nxënësi cikël i lartë	Mbështetëset dhe ulëset të jenë me material frezilit, i derdhur ne te gjithë trupin e ndenjtes dhe te shpines. Materiali i derdhur i frezilitit duhet te jete i qendrueshem kunder lageshtires dhe gervishtjeve. Ndenjtësia dhe shpina të jene te harkuara (me gropa në qendrën e ulëses dhe ne forme anatomike. Skeleti duhet te jete me profil tubolar oval ku ne te dyja anet e tubit te jete i rumbullakosur, qe te japi fortesine dhe imazhin e dukshem te karriges, me seksion jo më të vogël 30 x15mm dhe spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm. I gjithë skeleti të jetë i salduar me saldime të vazhduar me argon dhe i lyer me bojë elektrostatische, në pjesët fundore të ketë tapa plastike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012+A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)	35 x 38 x 42-45/70 cm	Copë

55	Karrige klase	<p>Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Me skelet metalik prej tubash çeliku diametër 18 të harkuar me lyerje elektrostatische. Shpinorja dhe ndenjësja janë plastike prej polietileni ose MDF e kombinuar me kompensate. Montohen në skeleton metalik me vida. Dimensionet e karrikes janë: ndenjësja 39-40 cm, shpinorja 77 cm, gjerësia 39-40 cm dhe gjatësia 60 cm.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012+A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)</p>	<p>Ndenjësja: 39-40 cm, Shpinorja: 77 cm, Gjerësia: 39-40 cm, Gjatësia: 60 cm.</p>	Copë
56	Karrige klase	<p>Karriget të jenë dizenuar me një stil modern me skelet metalik prej tubash çeliku me profil rrethor me diametër 21 mm dhe spesor jo më të vogël se 1.3 mm të harkuar dhe lyer me bojë elektrostatische. Shpinorja dhe ndenjësja janë MDF e kombinuar me kompensatë, të cilat montohen në skeletin metalik me vida ose preçina.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012+A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)</p>	<p>Ndenjësja: 38 x 38 cm, Shpinorja: 18 x 41 cm, - Lartësia e karriges: 77 cm, - Lartësia e ndenjësës 44 - 46 cm.</p>	Copë
57	Karrige laborator	<p>Karriget kërkohen të jenë rrotulluese, me ndenjësë mundësisht të rrumbullakët, me shpinore të ulët rreth 15 cm mbi nivelin e ndenjësës, me nivelim të rregullueshëm për ulje ngritje, me mbajtëse rrethore metalike për vendosjen e këmbëve dhe rrota të vendosura në këmbëzat për lëvizje. Lartësia minimale dhe ajo maksimale do të jenë 44-54 cm. Materiali i ndenjësës është me mbushje sfungjeri dhe veshje sintetike, pjesa tjetër material metalik.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012+A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)</p>		Copë
58	Karrige mence	<p>Karriget të jenë dizenuar me një stil modern me skelet metalik prej tubash çeliku me profil rrethor me \varnothing 21 mm dhe spesor jo më të vogël se 1.3 mm të harkuar dhe lyer me bojë elektrostatische. Shpinorja dhe ndenjësja janë MDF e kombinuar me kompensate, të cilat montohen në skeletin metalik me vida ose preçina.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012+A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)</p>	<p>Ndenjësja: 39 x 39 cm gjerësi, Shpinorja: 18 x 41 cm, Lartësia e karriges: 77 cm, Lartësia e ndenjësës 44 - 46 cm.</p>	Copë


59	Karrige për salla konferencash	<p>Karriget të jenë dizenuar me një stil modern me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval 30 x15 mm dhe spesor jo më të vogël se 1.3 mm dhe lyer me bojë elektrostатike. Shpinorja dhe ndenjësja në pjesën e brendshme kanë një kompesatë të kurbuar. Karriget kane krahë në dy anët e saj dhe në krahun e djathtë vendoset një tavolinë e vogël, e lëvizshme, për të shkruar. Ndenjësja dhe shpinorja montohen në skeletin metalik me vida. Shpinorja dhe ndenjësja kanë mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkure ekologjike.</p> <p>Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018</p>		Copë
